

VENDIM
Nr. 793, datë 14.11.2012

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR
KONTROLLIN E LARTË TË SHTETIT, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si autoritet kontraktor, të përfundojë kryerjen e procedurave të prokurimit, me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2012, në zërin “Shpenzime operative”, për objektin “Botimi i revistës “Auditimi publik” dhe botime të tjera”, me fond limit 1 900 000 (një milion e nëntëqind mijë) lekë, pa TVSH, deri në datën 24 dhjetor 2012. Brenda kësaj periudhe të përfshihet publikimi i fituesit dhe publikimi i njoftimit të kontratës së lidhur në buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

2. Ngarkohen Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha